



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.29.1-2012-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AUTORITETIT TË
AVIACIONIT CIVIL
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Maj 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderren, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti mbështetur nga Astrit Bllaca (Udhëheqës i ekipit), Alban Beka .

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	9
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	16
6 Konkluzioni i përgjithshëm	17
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP	18
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	20

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PVF-të) për vitin 2012 për Autoritetin e Aviacionit Civil (më tutje AAC). Unë do të doja të falënderoja Drejtorin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2012 ishte ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë fokusohej në:

- Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF);
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit); dhe
- Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij në formatin e përcaktuar në Shtojcën I – Opinionin e Auditimit. Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e ZAP. Raporti i AP-së përfshin një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e pasqyrave financiare.

Opinionin e AP-së është:

<p>Pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin <i>një pamje të drejtë dhe të vërtetë (SNISA 400 Opinion i Pakualifikuar)</i>.</p>

Konkluzioni i përgjithshëm

Niveli i punës së ndërmarrë nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) për të përfunduar auditimin e vitit 2012 është pasqyrim i drejtpërdrejtë i cilësisë së mjedisit të kontrollit të brendshëm të implementuar nga menaxhmenti. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

AAC ka dizajnuar sistem efektiv të kontrollit të brendshëm për të gjithat fushat e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Proceset dhe procedurat e implementuara kanë siguruar që menaxhimi financiar dhe kontrolli në AAC kryhet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe parimet e mirëfillta të qeverisjes së mirë.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim të mbështesin AAC në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe rritjen e aspekteve tjera të aktivitetit operacional. Ne kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimeve tona të bëra në vitin 2011 - pozita aktuale është përmbledhur në Shtojcën II. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se të gjitha rekomandimet janë adresuar në mënyrë efektive.

AAC ka inkorporuar kontrollet existuese financiare në Manualin për Menaxhim të Cilësisë. Rishikimi i jashtëm dhe certifikimi i kësaj në vitin 2013 do të konsolidojë pozitën e fortë ekzistuese në lidhje me kontrollin e brendshëm dhe të rezultojë në përmirësime të mëtejme kur është e nevojshme.

Kemi diskutuar cilësinë e raportimit financiar të AAC në lidhje me Pasqyrat Vjetore Financiare, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Llogaridhënien e Menaxhmentit si dhe Auditimin e Brendshëm në pjesën kryesore të këtij raporti.

Rekomandimi ynë kryesor është si vijon:

Auditimi i Brendshëm

- Në mungesë të një funksioni të auditimit të brendshëm, menaxhmenti duhet të konsiderojë shtrirjen rolit të menaxherit të cilësisë në shqyrtimin e kontrolleve të brendshme që lidhen me sistemet financiare për të siguruar që menaxhmenti të marrë siguri të vazhdueshme në lidhje me funksionimin efektiv të tyre.

Menaxhmenti i AAC-së është pajtuar me të gjeturën tonë të auditimit dhe është zotuar se do ta adresojë rekomandimin.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e AAC të përgatis pasqyrat financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për AAC. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testeve të përgjithshme e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të menaxhimit financiar dhe kontrollit në AAC. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjendet në Shtojcën II.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një vlerësim gjithëpërfshirës të dobësive potenciale të cilat ekzistojnë, apo përmirësimet potenciale që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i pasqyrave vjetore financiare merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e pasqyrave vjetore financiare përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. Një numër i pikëve në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

PVF ishin përgaditur në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. AAC ka përdorur formatin standard për raportim, dhe ka plotësuar të gjitha kërkesat në pajtueshmëri me kornizën për raportim.

Përshkrimi

Pasqyrat vjetore duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi vërejtur se:

- PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave (MF);
- PVF janë nënshkruar nga ZKA dhe ZKF;
- PVF janë pranuar në gjuhën shqipe dhe serbe; dhe
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura gjatë auditimit të 9 mujorit në lidhje me kornizën raportuese në memon tonë të datës 14/12/2012 janë adresuar nga Menaxhmenti.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

Konkluzioni i përgjithshëm

Kemi analizuar cilësinë e informatave të prezantuara në PVF. Ne vlerësojmë se informatat e prezantuara në PVF-të 2012 janë të plota dhe të sakta si dhe janë dhënë shpалosjet e duhura.

Përshkrimi

Nuk ka ekzistuar nevoja për asnjë rregullim financiar apo jo-financiar në draft PVF-të e pranuar nga AAC. Informatat e prezantuara dhe shpалosjet ishin të duhura. Çështjet minore të ngritura nga auditorët gjatë nëntëmuorit të vitit 2012 siç është zhvlerësimi i pasurive janë adresuar nga menaxhmenti dhe si e tillë deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF kur draft PVF-të të dorëzuara në Qeveri japin një vlerësim të duhur të cilësisë së informacionit të dhënë.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.3 Opinioni i Auditimit

Pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë*(SNISA 400 **Opinion i Pakualifikuar**).

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

AAC ka adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna për vitin 2011. Veprimet dhe afatet kohore të përcaktuara në planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve të ZAP-së kanë gjetur zbatim plotësisht edhe në praktik.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2011 të AAC-së ka rezultuar me 5 (pesë) rekomandime kryesore. AAC ka përgatitur një Plan Veprimi duke siguruar se të gjitha rekomandimet do të adresohen. Të gjitha rekomandimet janë adresuar plotësisht. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky mund, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjat e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

AAC gjatë vitit 2012 ka hartuar Manualin për Menaxhimin e Cilësisë. Qëllimi i këtij manuali është të konsolidojë Sistemet Menaxhimit të Cilësisë në AAC. Në kuadër të këtij manuali i gjithë sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit është përshkruar dhe ndërlidhur me ligjet në fuqi. Kjo do të jetë subjekt i rishikimit të jashtëm dhe certifikimit në vitin 2013 dhe ku sistemet e duhura do të ngriten më tej. Si e tillë, AAC është vendosur mirë për të ruajtur sisteme të fuqishme të kontrollit të brendshëm pasi që çdo zyrtarë në zingjirin e llogaridhënies ka përgjegjësi të qartë në lidhje me fushat e deleguara.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

AAC ka shpenzuar 93% të buxhetit ndikimi i afateve kohore për procedurat e rekrutimit në shpenzimet e pagave dhe mëditjeve është marrë parasysh.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për AAC-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (ne euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Burimet e Fondeve:	750,498	789,558	731,568	715,316	710,113
Granti i Qeverisë-Buxheti	750,498	789,558	731,568		
Të hyrat vetanake ²				715,316	710,113

Tabela 1 tregon që AAC për vitin 2012 ka shpenzuar vlerën prej 731,568€ apo 93% të vlerës së përgjithshme të buxhetit. Buxheti fillestar është rritur me rishikim për vlerën prej 39,060€. Kjo rritje është bërë me kërkesë të AAC-së.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (ne euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	750,498	789,558	731,568	715,316	710,113
Pagat dhe Mëditjet	380,125	419,185	379,386	385,747	339,447
Mallrat dhe Shërbimet	361,073	354,330	339,108	314,133	361,430
Komunalitë	9,300	16,043	13,074	15,436	9,237

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Një pjesë e faturave të planifikuara dhe të mbledhura për Buxhetin e Kosovës në vitin aktual që është përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Tabela nr. 2 tregon shpenzimet dhe ndryshimet e buxhetit nëpër kategori. Këto janë të prezantuara në vijim:

- 91% e buxhetit për paga dhe medijtje është shpenzuar pas rritjes në buxhet prej 39,060€. Afatet kohore të rritjes buxhetore nuk kanë lejuar që procedurat e rekrutimit të implementohen me kohë në mënyrë që të lejohet shpenzimi i buxhetit të rritur;
- Për mallra dhe shërbime, vlera prej 6,473€ ishte transferuar në kategorinë shërbime komunale. Realizimi i buxhetit për kategori ishte 96%; dhe
- Buxheti për kategorinë shërbime komunale ishte shpenzuar në vlerë prej 13,074€ apo 81%.

Tabela 3. Të hyrat e mbledhura për buxhetin e Kosovës - realizimi ndaj buxhetit (ne euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Të hyrat nga tarifat për sigurinë e pasagjerëve			1,489,450	1,286,414	1,262,600
Të hyrat nga tarifat për licenca/certifikata			8,700	2,900	

Tabela tregon që AAC për vitin 2012, kishte realizuar të hyra në vlerë prej 1,498,150€. (për më tepër shiko kapitullin 4.4 Të hyrat).

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.3 Kërkesat e raportimit

Konkluzioni i përgjithshëm

AAC ka përmbushur kërkesat raportuese që dalin nga ligjet në fuqi dhe ka respektuar afatet e kërkuara.

Përshkrim

Gjatë vitit 2012 AAC ka përmbushur përgjegjësitë për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesat Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;

-
- Raportet Operacionale (performancës) ;
 - Draft Planin dhe Planin përfundimtar të prokurimit me kohë;
 - Raportet mbi borxhet e dorëzuar në MF;
 - Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit; dhe
 - Planin e Veprimit për implementimin e rekomandimeve.

Rekomandimet

Ne nuk kemi asnjë rekomandim në këtë fushë.

4.4 Të hyrat

Konkluzion i përgjithshëm

AAC ka dizajnuar një sistem të mirë për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave për vitin 2012.

Përshkrimi

AAC inkason të hyra nga tarifatat për sigurinë e pasagjerëve, si dhe nga lëshimi i licencave dhe çertifikatave. Tarifa e sigurisë së udhëtarëve që udhëtojnë me fluturime komerciale nga Kosova është e përcaktuar me Rregulloren 07/2008. Ndërsa përcaktimin e tarifës për dhënie të licencave/çertifikatave është Rregullorja 07/2011).

AAC gjatë vitit 2012 ka mbledhur të hyra në vlerë prej 1,498,150€. Në këtë vlerë janë të përfshira, të hyrat e mbledhura nga tarifatat e çertifikimit dhe licencimit në vlerë prej 8,700€. Një pjesë e këtyre janë alokuar në buxhetin e AAC dhe pjesa e mbetur në buxhetin e Kosovës.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm

AAC i kupton nevojat e kontrolleve të forta të sistemeve në këtë fushë dhe ekziston një sistem i dokumentuar i menaxhimit të shpenzimeve. Bazuar në testet e ndërmarra ne kemi konfirmuar se AAC ka një varg sistemesh të kontrollit të brendshëm në funksion. Kjo ka ndihmuar në sigurimin që AAC të arrijë objektivat e përcaktuara, dhe përdorimin më të mirë të parasë publike, dhe gjithashtu ka siguruar raportim të besueshëm financiar.

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Zyrtari i prokurimit kishte hartuar planin e prokurimit për vitin 2012 bazuar në kërkesat ligjore. Gjatë vitit 2012, AAC ka realizuar 18 prokurime sipas aktiviteteve dhe afateve të kërkuara me planin e prokurimit.

Ne kemi testuar dhe analizuar mënyrën e menaxhimit të prokurimit dhe pagesave të ndërlidhura me këto prokurime. Testimet tona nuk kanë nxjerrë në pah ndonjë mangësi.

Në raportin e auditimit tonë për vitin 2011, ne kemi rekomanduar AAC të shtoj monitorimin rreth menaxhimit të kontratave në lidhje me afatet të skadimit të kontratave dhe lidhjen e kontratës për furnizim me bileta të udhëtimit. Gjatë auditimit ne kemi vërejtur që AAC, ka përforcuar monitorimin dhe menaxhimin e kontratave dhe për këtë qëllim ka hartuar procedura të brendshme, si dhe ka lidhur kontratën për furnizim me bileta të udhëtimit.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5.2 Shpenzimet tjera

Përshkrim

Blerjet tjera që nuk i nënshtrohen prokurimit përfshijnë : komunalitë, shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet për shërbime intelektuale si dhe këshillëdhëse. Ne kemi testuar pesë (5) transaksione me vlerë totale prej 6,754€.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Sistemi i pagave është një sistem ku AAC ka operuar me një numër kontrollesh lokale si në vijim:

- mbajtjen dhe azhurnimin e rregullt nga zyra e personelit të dosjeve të të punësuarve; dhe
- sektori i financave është njoftuar rregullisht dhe me kohë lidhur me ndryshimet në paga dhe mëditje.

Për vitin 2012, AAC ka pasur gjithsej 22 të punësuar. Ne kemi testuar sistemin e pagave dhe nga testimet e kryera ne nuk kemi hasur në ndonjë mangësi në këtë fushë.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.6 Pasuritë

Konkluzioni i përgjithshëm

AAC ka dizajnuar një sistem të mirë për regjistrimin, mirëmbajtjen dhe raportimin e të gjitha pasurive. Komisionet relevante janë funksionale dhe kanë ndërmarrë vlerësimet e nevojshme në vitin 2012.

4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Në bazë të UA nr. 21/09 organizata buxhetore është e obliguar të themelojë çdo vit komisionin për vlerësimin e pasurisë dhe komisionin për inventarizimin e pasurisë. AAC gjatë vitit 2012 ka themeluar komisionet përkatëse dhe ka kryer inventarizimin dhe vlerësimin e pasurisë sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ.

Lista e pasurive mbi 1,000€ të AAC-së e marrë nga Thesari dhe e prezantuar në PVF-të 2012 është në vlerë neto prej 14,562€. Gjatë auditimit kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit, mënyra e mbajtjes së evidencës dhe menaxhimi i pasurive jo financiare në AAC është kryer konform kërkesave të UA nr.21/2009 mbi menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive Qeveritare. Testimet tona nuk kanë identifikuar mangësi në menaxhim të pasurisë.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.6.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Të hyrat për periudhën nëntor-dhjetor të cilat kanë mbetur si llogari të arkëtueshme janë në vlerë prej 210,072€. Kjo është shifër e ngjashme me atë në vitin 2011 dhe reflekton memorandumimin mes AAC-së dhe Limak Kosova, ku mjetet transferohen në llogarinë e AAC-së 45 ditë pas përfundimit të çdo muaji.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.7 Trajtimi i borxheve

Konkluzioni i përgjithshëm

AAC në vitin 2012 ka raportuar obligimet e papaguara në pajtim me kërkesat ekzistuese.

Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2012 ishte në vlerë prej 3,070€. Këto detyrime kishin të bënin me faturat e pranuar në fund të vitit dhe si të papaguara janë bartur për t'u paguar në vitin 2013.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzioni i përgjithshëm

AAC-ja nuk i plotëson kriteret për themelimin e NjAB-së, por është sugjeruar që puna e AB-së në kuadër të AAC të kryhet nga Ministria e Financave. Në mungesë të kësaj, mund të merret parasysh ofrimi i sigurisë së mjaftueshme nga menaxhmentimi funksionimin e vazhdueshëm të kontrollit të brendshëm.

Përshkrimi

AAC nuk ka në funksion auditimin e brendshëm. Sipas U/A nr. 23/2009, AAC nuk plotëson kriteret për themelimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm (më tutje NjAB). Megjithatë, udhëzimi i lartëpërmendur rregullon rastet kur organizatat nuk i plotësojnë kriteret për auditim të brendshëm dhe ofron mënyra tjera të sigurimit të këtyre shërbimeve.

Në auditimin e vitit 2011, ne kishim rekomanduar AAC të diskutoj me komisionet relevante në Kuvendin e Kosovës, për sigurimin e një zgjidhje afatgjate për shërbimin e auditimit të brendshëm. Menaxhmenti i AAC, këtë çështje e ka ngritur tek Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Komisioni ka ardhur në përfundim se Auditimin e brendshëm për Organizata Buxhetore të cilat nuk plotësojnë kriteret për themelimin e NJAB-së, duhet të kryhen nga Departamenti i auditimit të brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave.

Rekomandim

1. Çështja - Adresimi i mungesës së NJAB-së - Prioriteti- i rëndësishëm

- | | |
|----------------------|---|
| E gjetura | Derisa AAC-ja nuk i plotëson kriteret për NJAB, nuk ka veprime specifike për të zvogëluar rreziqet që lidhen me këtë. |
| Rreziku | Nëse nuk bëhen rishikime nga AB, nuk mund të identifikohet reduktimi në efektivitetin e kontrolleve të brendshme. |
| Rekomandimi 1 | AAC-ja duhet të konsiderojë shtrirjen rolin e menaxherit të cilësisë në rishikimin e kontrolleve të brendshme që lidhen me sistemet financiare për të siguruar që menaxhmenti të marrë siguri të vazhdueshme në lidhje me funksionimin efektiv të tyre. |

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni jonë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe të Sistemit të Auditimit të Brendshëm. Këto mund të përmbliidhen si:

AAC-ja ka të dizajnuar sistem efektiv të kontrollit të brendshëm për të gjitha fushat e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Proceset dhe procedurat e zbatuara kanë siguruar se menaxhimi financiar dhe kontrolli në kuadër të AAC është kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe parimet e qeverisjes së mirë.

Si rezultat i këtyre kontrolleve të forta, për të gjitha fushat e shpenzimeve dhe të hyrave ne kemi qenë në gjendje të kemi siguri nga niveli i lartë i kontrolleve të implementuara nga menaxhmenti. Në mënyrë të veçantë, rishikimi i hollësishëm dhe monitorimi i ndërmarë nga Drejtori i Administratës është diskutuar në detaje me Drejtorin e Përgjithshëm dhe është dokumentuar në takimet mujore.

Në përputhje me një qasje proaktive për çështjet e menaxhimit financiar, AAC ka adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna për vitin 2011. Veprimet dhe afatet kohore të përcaktuara në planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZAP-it janë zbatuar plotësisht në praktikë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një **opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifikë të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinion i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinion i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhena	Rekomandimet plotesisht te adresuara	Rekomandimet pjeserisht te adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1. Prokurim	Ka kryer rishikime të vazhdueshme të validitetit të kontratave me qëllim që aktivitetet e prokurimit të kryhen me kohë.	PO		
2. Blerjet tjera	2.1 Ka analizuar shpenzimet e ndërlidhura me biletat e udhëtimit, dhe ka zhvilluar procedurat e prokurimit për zgjedhje me te favorshme te këtyre shërbimeve. 2.2 Ka shtuar kontrollet rutinore në sektorin e financave dhe stafit të përfshirë në këtë sektor i ipet mundësia për përditësimin e te dhënave	PO		
3. Pasuria	Është respektuar UA nr. 21 / 09 mbi menaxhimin e pasurisë.	PO		
4. Auditimi	Ka diskutuar me komisionet relevante në Kuvendin e Kosovës për sigurimin e një zgjidhje afatgjate për shërbimin e auditimit të brendshëm	PO		
5. Konkluzioni përgjithshëm	Rishikimin e proceseve dhe procedurave aktuale me qëllim të zbatimit të plotë të kërkesave të Menaxhimit të Financave Publike	PO		